



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja, nr. 07

Prishtinë, më 16.6.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selvije Halimi, Albulena Haxhiu dhe Milena Miliqeviq.

Munguan: Danush Ademi, Donika Kadaj-Bujupi dhe Enver Hoti.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti – GLPS, Albert Krasniqi – KDI, Visar Rushiti – GAP, Arta Krasniqi – OSBE, Floriana Merovci – ZPRK, Besnik Tahiri – Klan Kosova, Floriana Shala dhe, Driton Selmanaj – KDI, Xheladin Hoxha – Drejtor në DMKP dhe Blerta Bejtullahu – URSR/Office.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Hartimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Armend Zemaj, kryetar, tha se do të vazhdojmë aty ku kemi mbet, tek neni 43 dhe ku kërkoi që në paragrafin 2.3, fjala “suplementar” të zëvendësohet me fjalët “i deputetit” dhe kjo vlen për tërë tekstin e Projektligjit.

Albulena Haxhiu, tha se qëndrimi im për këtë dispozitë tashmë dihet sepse paga e deputetit është në shpërpushje me gjendjen sociale e ekonomike në vend. Ju e dini që ka një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me pensionin suplementar dhe ne në vazhdimësi e kemi kundërshtuar që deputeti të ketë pension suplementar.

Kryetari kërkoi që për këtë pjesë të diskutojmë vetëm për terminologji sepse këtë kapitull ja kemi dërguar Komisionit për Buxhet dhe Financa, për komente rreth implikimeve buxhetore.

Ndryshime u bënë edhe në nenin 56.1 dhe ai u riformulua si vijon: “Sekretari i Kuvendit zgjidhet dhe shkarkohet nga Kryesia.” Në paragrafin 3, të këtij neni, fjala “parashtruar kërkesë brenda”, zëvendësohet me fjalën “konkurruar sipas afatit”.

Në nenin 58.3, fjala “udhëheqësit”, zëvendësohet me “kryetaret”, ky ndryshim bëhet edhe në paragrafin 4.

Albulena Haxhiu, kërkoi që për nenin 58, të mos diskutohet shumë, pasi ky nen duhet të analizohet më shumë nga grupet parlamentare sepse po kemi problem me këtë çështje.

Në nenin 59.1.1, fjalët “opcion të partisë” zëvendësohet me “subjektet”, kurse në 1.5 fjalët “mund të mos” zëvendësohet me “nuk mund”.

Neni 60.6, riformulohet si vijon:” 6. Paga e stafit politik parlamentar paguhet nga Kuvendi, sipas një grade të pagave të përcaktuar me rregullore të brendshme, gjithashtu duke marrë parasysh gradën e pagave të nëpunësve civilë parlamentarë në pozitë të krahasueshme.”.

Nga neni 62 e tutje do të vazhdohet gjatë punëtorisë.

Në fund të takimit, kryetari Armen Zemaj ua rikujtoi të pranishmëve se gjatë punëtorisë që do ta mbahet më 22 dhe 23, duhet që ta rishikojnë edhe njëherë në tërësi tekstin e Projektligjit, para se atë ta procedojnë në Komision.

3. Të ndryshme.

Në këtë pik nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj